

## MENAXHIMI I TOKËS NË PEMËTORE

( për kulturat bërthamore)

Në kushtet e një bujqësie moderne sot menaxhimi i tokës ka koncepte të reja në trajtimin e saj. Nga studimet e bëra mbi këtë çështje ka patur përfundime dhe pikëpamje të ndryshme.

Por ajo që i bashkon është ndërhyrja sa më e pakët në sipërfaqet e mbjella me pemë frutore pasi ruhet më mirë ekosistemi dhe minimizohet erozioni, sidomos në zonat kodrinore ku shtrihet pjesa më e madhe e sipërfaqeve të mbjella me pemë frutore.

Për të përcaktuar mënyrën më të mirë të mbajtjes së tokës në pemëtoret e bazës eksperimentale Shamogjin u ngrit ky studim:

Studimi u krye në disa prova

**Prova e parë.** Mbajtja e tokës ugar.

**Prova e dytë.** Mbajtja e tokës me herbicid.

**Prova e tretë.** Mbajtja e tokës Leguminoze (bathë, bizele, tërfil).

Toka u mboll me bimët leguminoze në muajin Tetor të vitit të kaluar dhe u përmbys në muajt Prill-Maj.

U trajtua toka me herbicid në periudhën Maj - Qershor për të mbajtur tokën të pastër nga barërat e këqija.

Megjithë se kemi të bëjmë me demonstrim të mirëfillt për trajtimin e tokës me mënyra të ndryshme në kulturat drufrutore, por, për të përcaktuar mënyrën më të mirë midis tyre u pa e domosdoshme të ndiqeshin disa tregues që në analizën e fundit dëshmojnë për mënyrën më të mirë.

U analizuan këta tregues:

-Rritja vjetore e kurorës, treguesit e rritjes së bimës (trashësia e trungut, volumi i kurorës në m<sup>3</sup>);

-prodhimi për çdo specie dhe kultivar.


Krahasimet u bënë në variantin e parë ku toka u trajtua ugar (e punuar).


Pas përpunimit statistikor të treguesve rezultatet janë si më poshtë:

### Diskutime dhe rezultate

#### 1. Rritja vjetore e kurorës

Matjet u kryen në dy periudha, në muajin Mars në momentin pas krasitjes kur bima është në qetësi dhe në muajin Nëntor kur ka mbaruar rritja vjetore e pemës.





Nga përpunimi i të dhënave për treguesin e rritjes së vëllimit të kurorës rezulton se prova me rezultatin më të mirë është ajo e përdorimit të leguminozeve pasi vëllimi i kurorës ka një rritje të ndjeshme në krahasim me dy provat e tjera.


Në provën e dytë duke përdorur herbicid dhe në provën e tretë duke e lënë tokën të punuar ugar ndryshimet janë shumë të vogla, por në provën e dytë duke përdorur herbicid kostoja e punës është më e vogël se në provën e parë.




Trajtimi i tokës me herbicid në pjeskë e kajsi

Në rastin kur toka midis rreshtave u mboll me leguminoze, në rastin tonë me bizele dhe bathë, treguesit për prodhimin kanë dominuar mbi provat e tjera.

## 2. Rritja e sipërfaqes së trungut





Nga përpunimi i të dhënave për treguesin e rritjes së sipërfaqes së tringut, rezultatet e mara gjatë matjeve të bëra në muajin Mars dhe në në muajin Nëntor tregojnë se: Ndryshimi më i madh në rritjen e tringut, gjë e cila çon dhe në rritjen e fuqisë së bimës është evidentuar në provën ku është përdorur mbjellja e bimëve leguminoze.

Në provën e dytë duke përdorur herbicid dhe në provën e tretë duke e lënë tokën të punuar ugar ndryshimet janë shumë të vogla midis tyre .

## Konkluzione

1.Mbjellja midis rreshtave me bimë leguminoze azotofiksuese siç janë: batha, bizelja, tërfili, ka ndikim të madh në përmirësimin e vetive të tokës në drejtim të pasurimit të saj më elementin N “azot” në trajta të asimilueshme. Është i njohur fakti se në këto bimë në sistemin rrënjor zhvillohen nëpërmjet mikorizës bakterie të cilat mundësojnë fiksimin e azotit atmosferik të cilin e shndërojnë në kripëra me përmbajtje azoti të asimilueshëm nga bimët e tjera që kultivohen në këto ambiente.

Përveç këtij fakti, mbjellja e tokës me leguminoze, korrija e përmbysja e tyre me punime të ndryshme në periudhën e lulëzimit (25% e bimëve ndodhen në këtë fazë), depoziton në tokë një sasi mase bimore. Kjo masë e gjelbër në sajë të proceseve të ndryshme të fermentimit dhe dekompozimit kthehet në lëndë organike e pasur me elementë të azotit, potasit, kalçiumit me makro dhe mikro elementë të tjerë lehtësisht të asimilueshëm nga bimët.

Për kultivarët që rezultojnë me pjekje të hershme në kulturat bërthamore ku frutat piqen në periudhën e Maj-Qershorit, përmbysja bëhet më herët, në muajin Prill (Qershi).

Përveç masës organike që depozitohet në tokë përmirësohen edhe vetitë e strukturës së saj.

-pastrohet mikroflora,

-përmirësohet pjelloria natyrale,

-përmirësohet qarkullimi i lëndëve organike nga toka në bimë nëpërmjet funksionimit më të mirë të rrjetit të komunikimit të lëndëve nga toka në bimë si rezultat i përmirësimit të strukturës së tokës, aktivizohet procesi i biosintezës, frymëmarrjes, shkëmbimit të gazrave, etj.

2.Nga të dhënat eksperimentale ka dalë se, në mbajtjen e tokës të punuar dhe eliminimit të bimëve konkurruese nëpërmjet herbicideve ndryshimi në prodhimin e realizuar ka qenë i vogël, që në gjuhën e përpunimit statistikor nuk përbën ndryshim për t’u marrë në konsideratë.

3.Përdorimi i herbicideve për luftim të barërave konkurruese duhet vlerësuar në faktin se kursehet fuqia punëtore, për kryerjen e punimeve dhe prashitjeve duke ndikuar në uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave. Është e këshillueshme që të përdoret kjo metodë për mbajtjen e tokës pastër në ato zona ku ndihet mungesa e fuqisë punëtore.

## ***Bibliografia***

R.A. Cline - Horticultural Research Institute of Ontario; Maribeth Fitts - Horticultural Crop Advisor/OMAF

Childers, N.F. 1978. *Modern Fruit Science*. Rutgers University.

Follett, R.H. and D.G. Eestfall. 2004. [\*Zinc and Iron Deficiencies\*](#), Colorado State University Extension Fact Sheet 0.545

Larsen, H.J., A.G. Gaus, R.J. Zimmerman, M. Rogoyski. 1998. *Colorado Tree Fruits: Pest and Crop Management Guide*. Colorado State University Extension bulletin XCM-41.

## **Specialist**

Athina Llambro

Lumturi Xhelilaj